

**Hapet thirrja për aplikime për studentët e doktoraturës  
në Universitetit Palacky, Olomouc-Çeki,  
në kuadër të programit Erasmus+ për vitin akademik 2025-2026**

Në kuadër të programit Erasmus+ është hapur thirrja për aplikime për **3 (tre) bursa** për mobilitete për studentët e ciklit të tretë të studimeve në Fakultetin e Shkencave të Rehabilitimit pranë Universitetit Palacky, Olomouc-Çeki, Itali për vitin akademik 2025-2026.

**Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

- Shkëmbimin e studentëve PhD për trajnim;

**Nivelet e mobilitetit për studentët:**

- Doktoraturë;

*Studentët aplikues duhet të plotësojnë këto kushte:*

1. Të jenë studentë të regjistruar në programet e ciklit të tretë të studimeve të Universiteti i Sporteve të Tiranës.
2. Të jenë punonjës me kontratë të plotë punësimi;
3. Të kenë njohje të gjuhës angleze të certifikuar sipas udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

**Kohëzgjatja e bursave:**

- deri në 1 (një) javë

**Fushat e shkëmbimit:**

Bursat/mobilitetet,do të jenë në fushat si vijon:

- Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti
- Shkencat Sportive

**Bursat përfshijnë:**

- Kompensimin ditor;
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës);

Për të përcaktuar distancën ju lutem referojuni link-ut:

<https://erasmus-plus.ec.europa.eu/resources-and-tools/distance-calculator>

## **Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e ciklit të tretë:**

- *CV në gjuhën angleze (formati EUROPASS);*
- *Fotokopje e pasaportës;*
- *Vërtetim studenti;*
- *Letër motivivimi në gjuhën angleze, ku specifikohet arsyeja e dëshirës për të marrë pjesë në këtë mobilitet dhe se si konkretisht ky mobilitet do të ndihmojë kerkimin e kandidatit;*
- *Çertifikatë e gjuhës së huaj (anglisht);*
- *Letër rekomandimi (anglisht);*

### **Afati për aplikim: 29 maj 2026**

Dokumentet duhen dorëzuar dorazi deri më **29 maj 2026**, pranë Zyrës së Protokollit në UST dhe të dërgohen të skanuara në adresën e-mailin [erasmus@ust.edu.al](mailto:erasmus@ust.edu.al).

Për më shumë informacion mbi bursat e mobiliteteve mund të na kontaktoni në adresën; [erasmus@ust.edu.al](mailto:erasmus@ust.edu.al)

*Universiteti i Sporteve të Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!*